

Data 01.08.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

"Blerje goma për automjetet e Drejtorisë së Infrastrukturës Rrugore, Drejtorisë së Shërbimeve Komunale , Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Klubit Sportiv, Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, Sektorit të MZSH-së"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34350000-5/(Goma per automjete te renda/lehta)

VLERA E FONDIT LIMIT:

1, 733, 297 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gramsh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit ,sipas Shtojcës 8*
- b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriteve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa **40%** të vlerës së përlogaritur të kontratës,përkatësisht në shumën **693 319 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë)lekë.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë dokumentacion dhe të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, Vlera e marzhit te xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar si më sipër konsiderohet tregues i rëndësishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e një kufiri të ulët dhe ju jep mundësi ndë të tjera edhe operatoreve ekonomik të vegjel dhe të mesem të kenë akses në ofertë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-në Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare,(2020,2021,2022) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate ,përkatesisht në shumën **346 659 (treqind e dyzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë)lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë Gramsh), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi/ me qira ose kontratë bashkëpunimi 1 pikë servisi (gomisteri) brenda juridiksionit të bashkisë Gramsh e cila do të shërbejë për heqjen e gomave të vjetra dhe vendosjen e gomave të reja.

- Në rast të disponimit të pikës së servisit (gomisterisë) në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e tij
- Ndërsa për pikën e servisit të marrë me qira/kontratë bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/ bashkëpunimit.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me anë të një deklaratë ku operatori ekonomik deklaron se në rast të shpalljes fitues merr përsipër ndërrimin e gomave dhe do të dorëzojë dokumentacionin e sipërcituar për pronësinë/qiranë ose kontratë bashkëpunimi për 1 pikë servisi (gomisteri)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të pikës 4 dhe 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur për të shmangur kostot shtesë të autoritetit kontraktor si (karburant, kohë, burime njerëzore etj) si dhe për arsye të mungesës së pajisjeve dhe mjeteve që nevojiten për ndërrimin e gomave.

Prandaj, kriteri i distancës kërkohet për shkak të specifikës së objektit të prokurimit pasi kontraktimi me një pikë servisi më të largët nuk do të ishte eficient për AK, dhe nuk do të arrihej në kohë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për realizimin në kohë të shërbimeve objekt të prokurimit duhet të ketë në pronësi ose qira të paktën 1 (një) automjet me kapacitet mbajtës minimalisht 3.5 ton. Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin, Taksën e qarkullimit, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë

kontratën e qirasë për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Taksën e qarkullimit, Kolaudimin,) të vlefshme.

Shënim:Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me goma , automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të ketë të punësuar **minimalisht 2 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe të dorëzojë listë-pagesat ku të figurojnë të paktën muajin e fundit Qershor 2023.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga Komisioni i ngritur sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.146 , datë 03.07.2023 "Për ngritjen e komisionit për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit" për procedurën me objekt "Blerje goma për automjetet e Drejtorisë së Infrastrukturës Rrugore, Drejtorisë së Shërbimeve Komunale , Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Klubit Sportiv, Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, Sektorit të MZSH-së".